



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Maj -2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

#### 1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në vazhden e punëve, detyrave dhe aktiviteteve të shumta në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, gjatë muajit maj të vitit 2018, ka arrit me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i realizojë punët dhe detyrat e planifikuara për këtë periudhë kohore sipas planit të veprimit, njëherësh edhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

#### AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA, rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;

- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Ekipi në fjalë hulumton trendet e fundit të përdorimit të teknologjisë arsimore në vend dhe jashtë;
- P.sh. School Me ose platforma online të të nxënës (2018 – pilotim);

- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë/kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Identifikohen nevojat e mësimdhënësve për trajnime;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartohet programi i investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti, e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të të përfshihen edhe profesionist – ekspertë; nuk është mirë të duplikohet inspektimi);
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në Komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Trajnimi i mësimdhënësve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;

- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjella dhe realizimi i projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- Përgatitja e planit për furnizim të shkollave fillore me libra nga klasa 1-9;
- Planifikimi i menaxhimit të kontratës “Furnizimi me libra i bibliotekave shkollore”;
- Fillimi i implementimit të kontratës “Furnizimi me inventar i shkollave”;
- Fillimi i procedurave të prokurimit “Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve”;
- Furnizimi i nxënësve të nivelit të arsimit fillor me kiflet dhe qumësht.

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit maj të vitit 2018, kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar: 1 vizita informuese në shkollat fillore “Dardania”, ndërsa janë realizua edhe pesë vizita të përgjithshme në IP “Gëzimi Ynë”, shkollat fillore “Qamil Batalli”, “Ando Z. Çajupi”, “Dituria”

dhe në shkollën e mesme “Abdyl Frashëri”. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar edhe katër vizita speciale në: SHFMU “Asim Vokshi”, SHFMU “Ismail Qemali” dhe në SHML “Sami Frashëri” dhe “SHML “Xhevdet Doda”;

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatorin e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht ka arritur t’i zgjedhë 20 koordinatorë të shkollave dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 24/2016;
- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara, dhe në fund të muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i mbështet me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i mbanë të informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe ka përgatitur formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;
- Në dymbëdhjetë institucione edukativo-arsimore, janë formuar ekipe për vlerësimin e brendshëm të shkollës, dhe pritet që shumë shpejt ky numër të zgjerohet edhe në institucionet tjera;
- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimet joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues dy (2) nxënës-fëmijë, njëri fëmijë është me diagnozë paralizë cerebrale dhe është rekomanduar të vijojë mësimet në shkollë të rregullt, ndërsa fëmija i dytë me diagnozë autizëm, është rekomanduar që të vijojë mësimet në QB “Përparimi”.

## Ndarja e çmimit për fituesin e garës së matematikës

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës organizoi ceremoninë e ndarjes së çmimit për fituesin e garës së diturisë në shkencën e matematikës, garë e realizuar në bashkëpunim me Universitetin Primorska, Koper, Slloveni.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe rektori i Universitetit Primorska, prof. dr. Dragan Marushiq, bashkë me Dekanen e FAMNIT, prof. dr. Klavdija Kutnar.



Në emër të Komunës së Prishtinës, nënkryetari z. Selim Pacolli dhe Drejtori i Arsimit, z. Jonuz Salihaj, falënderuan mysafirët për bashkëpunimin e shkëlqyer, duke shpresuar që një bashkëpunim i tillë do të thellohet edhe më shumë në këtë fushë, pra në arsimim dhe edukim. Ata treguan se komuna e jonë është e interesuar që t'i shtyjë përpara nxënësit e suksesshëm, ashtu që t'iu mundësohet vijimi i studimeve në universitete të tilla si Primorska.

Rektori i Universitetit Primorska dhe Dekania e fakultetit FAMNIT, u shprehen të kënaqur me organizimin e garës dhe shkathtësitë që treguan nxënësit në fushën e matematikës, duke potencuar që një bashkëpunim i tillë me Komunën e Prishtinës do të vazhdon edhe në të ardhmen, ku nxënësit talent në fushën e matematikës të kenë mundësi për të vazhduar studimet në Universitetin e Primorska.



Rektori Marušič, ndau mirënjohje për të gjithë nxënësit pjesëmarrës në garën e matematikës, ndërsa fitues i garës, pra fituesi i bursës për të studiuar në Universitetin Primorska, është Besfort Shala nga shkolla "Sami Frashëri".

### **Profilizimi i mësuesve klasor (I-V)**

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me përfaqësuesit e Fakultetit të Edukimit të Universitetit "Hasan Prishtina", më 8 maj 2018 organizuan debat publik, lidhur me profilizimin e mësuesve të ciklit klasor I-V, iniciativë e filluar vitin e kaluar, ku synohet të arrihet një mësues/e për klasë.



Për këtë iniciativë kanë filluar të zhvillohen debatet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, për të kuptuar opinionin e gjithë akterëve të përfshirë në procesin arsimor për këtë çështje. Edhe Fakulteti i Edukimit është duke e realizuar një hulumtim në këtë drejtim dhe shumë shpejtë do të dalë me një vlerësim të përgjithshëm.

Një debat me karakter të tillë u zhvillua edhe në kryeqendër, ku pjesëmarrës ishin drejtuesit e 42 institucioneve edukativo-arsimore të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 70 mësues/e të secilës shkollë të komunës së Prishtinës, për të kuptuar perceptimin dhe mendimin e tyre rreth kësaj iniciative.

Rreth kësaj çështjeje nga debutuesit u shprehen mendime dhe këndvështrime të ndryshme lidhur me profilizimin e mësueseve,



por në përgjithësi përkrahen iniciativën, duke konsideruar se kjo do të reflektonte drejtpërdrejtë në specializimin e mësuesve dhe përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Kjo iniciativë e institucioneve përgjegjëse të arsimit, për profilizimin e mësuesve të klasave I-V, është si rezultat i zhvillimeve të hovshme bashkëkohore në sferën e arsimit dhe kërkesë për t'ju përgjigje zhvillimeve të kohës për një mësimdhënës dhe mësim-nxënies cilësore, sipas standardeve bashkëkohore;

- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhunë apo shkelje të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Drejtoria e Arsimit në koordinim me përfaqësuesit e programit ASSET “After School Support for Teens’ (Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt), program i financuar nga USAID dhe zbatuar nga KEC (Qendra për Arsim e Kosovës) në partneritet me FHI360 dhe Crimson Capital Corp, organizuan takim me përfaqësuesit e disa komunave të Republikës së Kosovës dhe drejtues të gjimnazeve, për t’u informuar për programin.



Ku qëllimi kryesor i programit është zhvillimi i shkathtësive për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë, duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre.

Po ashtu, ky programi ka për qëllim mbështetjen në zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulës Bërthamë për klasat X-XII, në veçanti duke ofruar përkrahje në fushën “Jeta dhe puna” e cila përfshin këshillim dhe orientim për karrierë, teknologji (përfshirë TIK-un), dhe edukimin për punë e ndërmarrësi. Për të përkrahur shkollat në zbatimin e projekteve praktike, Programi do t’i ndihmojë ato të themelojnë “Qendrat për karrierë dhe ndërmarrësi” me hapësirat e quajtura “Makerspaces” (hapësira kreative), që mund të shfrytëzohen gjatë dhe pas orarit mësimor.



Pra, programi ASSET që një vit është duke implementuar në gjimnazin “Xhevdet Doda” dhe po planifikohet të zgjerohet edhe në dy gjimnaze tjera në Komunën e Prishtinës dhe në dhjetë komuna të tjera.

Programi synon të përkrahë Ministrinë e Arsimit dhe shkollat në zbatimin e Kurrikulës për edukim në karrierë dhe ndërmarrësi për klasat X-XII. Kjo do të përfshijë zhvillimin e instrumenteve vlerësuese për rezultatet e pritura mësimore, kurs të akredituar për mësimdhënës, burime dhe materiale mësimore, trajnimin e mësimdhënësve, dhe bashkëpunimin me partnerë për promovimin e “Qendrës virtuale të karrierës”, portal online për karrierë, në dispozicion për të rinjtë dhe prindërit e tyre brenda dhe jashtë sistemit shkollor.

Në bashkëpunim me partnerët, Programi synon të angazhojë bizneset dhe ndërmarrësit e interesuar që të përkrahin nxënësit në zhvillimin e shkathtësive për punë përmes projekteve dhe përvojës praktike. Aktiviteti i programit “Adopto një aset”, ka për qëllim t’u mundësojë bizneseve brenda dhe jashtë Kosovës të përkrahin nxënës të ndryshëm, duke iu ofruar përvojë pune, praktikë, këshilla për karrierë dhe mentorim.

Aktiviteti “Harta e të rinjve për komunitetin” do të angazhojë të rinjtë dhe të rriturit në identifikimin e burimeve, nevojave dhe mundësive në komunitet. Harta e të rinjve është aktiviteti i orientuar në veprim, ku të rinjtë hulumtojnë komunitetin e tyre përmes anketimeve dhe reflektimit mbi informacionet e dhëna. Përfshirja e të rinjve në këto aktivitete i pajis ata me shkathtësi, të cilat u mundësojnë të bëhen agjentë të ndryshimit dhe kontribues produktivë në komunitetin e tyre.

- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;



- Më 18 maj 2018, në autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit, u organizua “Testi i arritshmërisë” në nivel vendi, me nxënësit e klasave të nënta (IX). Këtij testi në komunën e Prishtinës iu nënshtruan 3594 nxënës;
- Drejtoria e Arsimit për një proces të drejtë dhe të standardizuar, ka ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme, duke organizuar testin në njëmbëdhjetë (11) qendra dhe duke krijuar kushte sipas standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe shpeshojmë edhe në rezultate më të mira dhe reale;
- Për një proces të mirëfilltë të testimit dhe vlerësimit të standardizuar, ka realizuar formën e organizimit të “Testit të arritshmërisë”, një nxënës një bankë, dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi.

Në funksion të këtij procesi, të gjithë akterët e përfshirë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e Testit të arritshmërisë, i kanë realizuar punët dhe detyrat me përgjegjësi të lartë, duke mundësuar që të kemi një proces të drejtë dhe me rezultate reale dhe objektive;

- **Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës**, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencën dhe Teknologjisë, më 22 maj 2018, organizuan takim informues me mësimdhënës lidhur me përgatitjet e organizimit të Provimit Shtetëror të Maturës dhe për punët detyrat dhe përgjegjësitë e administruesve dhe monitoruesve që do t’i kenë në këtë proces.



Është indikativ fakti se Provimi Shtetëror i Maturës, në Republikën e Kosovës këtë vit do të organizohet në disa faza dhe sipas rajoneve, ku në rajonin e Prishtinës testi do të organizohet më 29 maj dhe 6 qershor 2018.

Andaj, në këtë takim mësimdhënësit e komunës së Prishtinës, u



njoftuan se më datën e lartcekur do të administrojnë dhe monitorojnë testin e maturës në komunën e Podujevës, të Obiliqit, të Fushë-Kosovës dhe të Drenasit.

Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, u kërkua që mësimdhënësit e angazhuar në këtë proces, që në datat e potencuar të jenë të mobilizuar dhe punët dhe detyrat e përcaktuara t'i realizojmë me përgjegjësi, kompetencë dhe profesionalizëm të lartë, në mënyrë që gjithë ecuria e testit të rrjedhë sipas standardeve të kërkuara.

- **Faza e dytë e trajnimit të organizuar për zbatimin e KKK-së**

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në funksion të mbështetjes dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve për zbatimin e Kurrikulës së re nga viti i ri shkollor 2018/19, kanë ndërmarrë hapa konkretë në këtë segment, duke organizuar trajnime profesionale.



Drejtoria e Arsimit, në mënyrë që ky proces i filluar të gjejë zbatim në

institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, ka ndërmarrë veprime konkrete, duke iu përgjigjur profesionalisht kësaj situatë. Pra, më 5, 6, 12, 13 dhe 19 maj është organizuar faza e dytë e trajnimit për 150 mësimdhënës në pesë fushat e Kurrikulës, në këto fusha:

1. Gjuhët dhe komunikime, 33 mësimdhënës;
2. Shkencat natyrore, 29 mësimdhënës;
3. Shoqëria dhe mjedisi, 26 mësimdhënës;
4. Matematikë, 28 mësimdhënës dhe në 34 mësuese të ciklit klasor.

Kjo përgatitje e mësimdhënësve është realizuar, në mënyrë që zbatimi i Kurrikulës në shkollat tona, nga shtatori i vitit 2018, të jetë në nivelin e kënaqshëm;

- Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më 29 maj 2018 organizon pjesën e parë të Provimit Shtetëror të Maturës, me nxënësit e klasave XII;
- Drejtoria e Arsimit ka hapur konkurs për regjistrimin e fëmijëve - nxënësve në nivelin parafillor dhe klasës të parë, për vitin shkollor 2018/19;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;

- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit maj;
- Janë marrë nevojat nga shkollat për libra nga klasa 1-9 dhe është bërë kërkesa për libra në Ministri;
- Ka filluar furnizimi me inventar të shkollave;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kiflet dhe qumësht;
- Planifikimi i buxhetit vitit-18- për buxhet BDMS;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;
- Janë nënallokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënallokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë zotuar 250 lëndë për mallra dhe shërbime, si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar 200 lëndë;
- Miratimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 Euro;
- Mbajtja e evidencës së lëndëve të zotuar me modul blerjeje, si dhe dorëzimi në prokurim.

### 3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Organizimi dhe mbajtja e testit Shtetëror të Maturës, pjesa e dytë;
- Angazhimi i administruesve për mbarëvajtjen e testit të maturës;
- Furnizimi i institucioneve edukativo arsimore me kiflet dhe qumësht;
- Transporti për nxënës dhe arsimtar;
- Menaxhimi e kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore.

### 3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

### 3.1.2. Buxhetin e planifikuar dhe të shpenzuar për periudhën raportuese, maj 2018.

<b>Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 05-2018</b>				
<b>Kategoria Eko.</b>	<b>Alokim</b>	<b>Shpenzim</b>	<b>Zotim - Obligim</b>	<b>Mbetje -S=</b>
<b>Paga</b>	1.545.201,67	1.545.201,67	-	-
<b>Komunale</b>	115.110.22	71.546.58	41.382.53	2.181.11
<b>10-MSH</b>	176.634.30	88.721.59	59.136.23	28.776.48
<b>21-MSH</b>				
<b>Subvencione</b>	81.005.00	6.360.00	60.000.00	14.645.00
<b>Donacione</b>	72.037.73	18.771	-	53.266.73
<b>FB-21-Kapitale</b>	1.130.000.00	351.818.16	267.972.70	510.209.14
<b>FB-22-Kapitale</b>				
<b>Totali:</b>	3.119.988.92	2.082.419.00	428.491.46	609.078.46

### 3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit maj ka realizuar mbi 167 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

## 4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit maj të vitit 2018, janë realizuar takime me:

- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;

- përfaqësuesit e GIZ-it;
- përfaqësues të Ajovës;
- përfaqësuesit e Zyrës japoneze;
- përfaqësuesit e CIPOF-së;
- me IFC- Banka botërore;
- përfaqësuesit e Hendikosit;
- Ministrinë e Financave, takime të rregullta;
- përfaqësuesit e KUR "Prishtina";
- përfaqësuesit e Termokosit;
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

#### 4.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

### 5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.

- Gjatë muajit maj në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

#### 5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit maj janë pranuar gjithsej 52 lëndë, prej tyre të miratuara janë 14, të refuzuara 7 lëndë, të pezulluara 4 dhe në proces janë 27 lëndë.

### 6. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimmshënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësues të këshillave drejtues të institucioneve edukativo-arsimore.

## 7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;

- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimit të punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulës së re.

## 8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.:

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional, sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të Komunës së Prishtinës;
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

## 9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Transferimi (migracioni) i brendshëm i personelit dhe i mësimeve nga një shkollë në një shkollë tjetër dhe nga një vend pune në një tjetër në bazë të nevojave dhe mundësi;
- Sistemimi i mësimeve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;

- Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Monitorimi i zbatimit të Kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohet pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla;
- P.sh. "School Me" ose platforma online të të nxënit (2018 – pilotim);
- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;



- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në te të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë; nuk është mirë të duplikohet inspektimi);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionisti etj. në IP me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Trajnimi i mësimdhënësve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Fillimi i zbatimit të projektit “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra”;
- Fillimi i zbatimit të projektit “Furnizimi me rekuizita sportive i shkollave”;
- Vazhdimi i furnizimit të shkollave në mënyre sistematike me materialet e nevojshme ( didaktike, higjienike, ushqim etj.);
- Furnizimi i çerdheve me tepih;
- Furnizimi i çerdheve me material didaktik;
- DDD i institucioneve arsimore;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë.

## 10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.